



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:131174  
Datë: 27.03.2024  
Numri i dokumentit: 05508631

Ac.nr.7780/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Besnik Bislimaj kryetar i kolegjit, Fatmir Baloku dhe Bujar Muzaqi, anëtarë të kolegjit, në çështjen kontestimore të paditësit A.R.nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson av. M.Q. nga Prizreni, kundër të paditurve Ilirian Bytyqi nga Prizreni, të cilin e përfaqëson me autorizim av. B.Gj. nga Prizreni dhe Kushtrim Elez Kurtaj nga Prizreni, për shkak të kompensimit të dëmit, duke vendosur lidhur me ankesat e të paditurit Ilirian Bytyqi nga Prizreni, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.169/2017 datë 16.09.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 26.03.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

REFUZOHET e pa themelta ankesat e të paditurit Ilirian Bytyqi nga Prizreni, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.169/2017 datë 16.09.2021, VËRTETOHET.

Pika III e dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.169/2017 datë 16.09.2021, mbetet e pa shqyrtuar.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar, C.nr.169/2017 datë 16.09.2021, ka vendosur: I. PJESËRISHT APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit A.R.nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson av. Miftar Qelaj nga Prizreni, ashtu që DETYROHEN të paditurit Ilirian Bytyqi dhe Kushtrim Elez Kurtaj që të dytë nga Prizreni, që në emër të kompensimit të dëmit t'ia paguajnë solidarisht shumat si në vijim:

a). *Dëmi jo material:*

- Për të gjitha format e frikës së përjetuar shumë prej.....1.500.00 €.

- Për të gjitha format e dhimbjeve fizike të përjetuara shumë prej.....1,800.00 €.
- Për shëmtim të lehtë shumë prej.....350.00 €.
- Për zvogëlim të aftësisë së përgjithshme shumë prej.....600.00 €.

Në shumën e përgjithshme prej 4,250.00 € (katërmijë e dyqind e pesëdhjetë euro), me kamatë ligjore prej 8% nga dita e marrjes së aktgjykimit (16.09.2021) deri në pagesën e plotë, të gjitha këto brenda afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

b). Dëm material:

- Për ndihmë personit të tretë shumë prej.....150.00 €
- Për ushqim të përforcuar shumë prej..... 150.00 €

Në shumën e përgjithshme prej 300 € (treqind euro), me kamatë ligjore prej 8% nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (01.09.2014) deri në pagesën e plotë të gjitha këto brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

II. OBLIGOHEN të paditurit Ilirian Bytyqi dhe Kushtrim Elezkurtaj që në emër të shpenzimeve procedurale t'i paguajnë paditësit solidarisht shumë prej 774 € të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën ekzekutim të përmbarrimit të dhunshëm.

III. Pjesët tjera të kërkesëpadisë të kërkuara nga paditësi përtej shumave të aprovuara si në dispozitiv nën I të këtij aktgjykimi dhe kërkesa për rehabilitim fizioterapeutik refuzohen si të pabazuara.

Kundër këtij aktgjykimi, i padituri Ilirjan Bytyqi nga Prizreni, përmes të autorizuarit të tij av. Blend Gjini nga Prizreni, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë ta aprovoj ankesën si të bazuar, ta ndryshoj aktgjykimin e ankimuar, apo të njëjtin ta prishë dhe çështja të kthehet në gjykatën e shkallës së parë në ri procedurë dhe ri vendosje.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, si dhe shikimin, analizimin dhe vlerësimin shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurit Ilirjan Bytyqi është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi Arfim Rexha nga Prizren, përmes të autorizuarit të tij av. Miftar Qelaj nga Prizreni, me datën 01.09.2014, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi, kundër të paditurve Ilirian Bytyqi dhe Kushtrim Elezkurtaj që të dy nga Prizreni, për shkak të kompensimit të dëmit, të cilën kërkesë e ka precizuar me parashtresën e datës 06.07.2021.

Gjykata e shkallës së parë, duke vendosur sipas padisë së paditësit, pas mbajtjes së seancës për shqyrtim kryesor, dëgjimit të palëve ndërgjyqëse dhe administrimit të provave, ka marrë aktgjykimin e ankimuar C.nr.169/2017 të datës 16.09.2021, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur konkretisht si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Gjykata e shkallës së parë, në aktgjykimin e ankimuar mes tjerash ka arsyetuar se: Nga leximi i aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren P.nr.284/2009 të datës 23.06.2014, gjykata ka

vërtetuar faktin se këtu të paditurit Ilirijan Bytyqi dhe Kushtrim Elezkurtaj që të dytë nga Prizreni janë shpall fajtor për shkak të veprës penale të lëndimit të rëndë trupor nga neni 154 par.1 nën par.2 lidhur me nenin 23 të KPK-së dhe janë dënuar me kusht në kohëzgjatje prej 2 viteve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat prej 4 viteve, lidhur me lëndimet të rënda që ka pësuar këtu paditësi A.R.më datën 04.02.2009.

Më tej ka arsyetuar se: Nga leximi i ekspertizës psikiatrike të Dr. Naim Fanaj, e datës 17.03.2021, gjykata ka konstatuar se pas një konflikti verbal është sulmuar fizikisht paditësi i cili ka përjetuar lëndime të rënda trupore, ashtu që ka përjetuar frikë primare për 2-3 sekonda në momentin e sulmit kur ka perceptuar mundësinë e përfundimit fatal për veten. Ka përjetuar frikë sekondare të intensitetit të lartë 24 orë, e manifestuar si shqetësim intensiv nga rasti si dhe një frikë dhe ankth që shpërthente sa herë përkujtonte mundësinë e përfundimeve fatale për veten në atë konflikt fizik, e cila është manifestuar me pamundësi të gjumit, mendimeve negative, plogështi dhe dridhje, frikë sekondare të intensitetit të mesëm-dy javë dhe frikë sekondare me intensitetit të ulët që ka vazhduar rreth tetë muaj me detalisht të përshkruara në këtë ekspertizë.

Më tej ka arsyetuar se: Nga leximi i ekspertizës ortopedike-traumatologjike të Dr.Xhemajl Selmani gjykata ka konstatuar se paditësi si pasojë e lëndimeve të marrura nga të paditurit të përshkruara më hollësisht në këtë ekspertizë ka përjetuar lëndim të rëndë trupor. Këto lëndime paditësit i kanë shkaktuar dhimbje fizike dhe atë: a) të intensitetit posaçërisht të rëndë - në kohëzgjatje prej 20 min. nga momenti i aksidentit deri në marrjen e ndihmës mjekësore, b) të intensitetit të rëndë - që kanë zgjatur 24 orë kohë pas kohe deri në marrjen e terapisë kundër dhimbjes, c) të intensitetit të mesëm - në kohëzgjatje prej 14 ditë koha e nevojshme për fillimin e konsolidimit primar kockor dhe d) të intensitetit të ulët-që këto dhimbje ekzistojnë edhe sot e kësaj dite në formë të dhimbjeve të kokës, shpatullave, si dhe dhimbje e përcjellë me shtangim të parakrahut të djathtë gjatë shtrëngimit të grushtit. Shëmtim trupor shkalla e lehtë për shkak të vrajave nga prerja me thikë në pjesën e sipërme të brendshme të gishtit të III me përmasa 4x0,4 cm., tri vrajave në shpinë, dy prej tyre me gjatësi 1,5 cm. dhe një me gjatësi 1 cm., vrajë në formë të shkronjës L nga nën hunda në buzë e sipërme të majtë deri te vija anatomike e poshtme e fytyrës me krshet nga 1 cm (1+2 cm), dy vraja tjera në pjesë e sipërme të zverkut me nga 1 cm dhe një vraje tjetër në kufirin zverko-qafor me gjatësi 1,5 cm. Zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shkallë 1,5 % për shkak të kufizimit të lëvizjeve të gishtit të tretë të dorës së djathtë, në shkallë të rëndë bazuar në pikën 1.5.12b të tabelës mbi zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor, e miratuar nga MSH dhe BQK. Gjithashtu ndihma e personit të tretë - i është nevojitur në kohëzgjatje prej 21 ditë, ndihmë e cila konsiston në përgatitjen dhe ofrimin e ushqimit, mbajtjen e higjienës si dhe në nevojat e përditshme, siç është veshmbathja. Ushqim i përforcuar i është nevojitur në kohëzgjatje prej 30 ditë i pasur me proteina, albumina, karbohidrate, vitamina dhe minerale. Rehabilitim fizioterapeutik ka qenë i nevojshëm për dy herë nga dhjetë ditë brenda vitit të parë pas përleshjes fizike.

Më tej ka theksuar se: Me rastin e vendosjen gjykata në rastin konkret ka marr për bazë rrethanat e rastit konkret, e posaçërisht raportin e ekspertizës ortopedike-traumatologjike të Dr.Xhemajl Selmani, raportin psikiatrik të Dr. Naim Fanaj, aktgjykimin P.nr.284/2009 dhe provat tjera të cilat janë administruar në shqyrtimin gjyqësor në bazë të cilave gjykata konstatoi se paditësi A.R.si pasojë e lëndimeve të rënda të pësuar si rrjedhojë e përleshjeve fizike të datës 04.02.2009, ka përjetuar dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë, të rëndë, të mesëm

dhe të ulët, frikë primare, sekondare të intensitetit të lartë, të mesëm dhe të ulët, shëmtim trupor të lehtë, zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, ka pasur nevojë për ndihmë nga personi tretë, për ushqim i përforcuar dhe rehabilitim fizioterapeutik më arsyet e dhëna hollësisht sikurse në këtë ekspertizë. Duke marr për bazë gjendjen faktike të vërtetuar më lartë dhe dispozitat ligjore të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD 1978) të zbatueshme për këtë rast për shkak se kur është shkaktuar dëmi (04.02.2009) në fuqi ka qenë ky ligj, konkretisht të nenit 154 i cili përcakton se *“Kush i shkakton tjetrit dëmin, ka për detyrë ta kompensoj, në qoftëse nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij”*, të nenit 195 par.1 i këtij ligji përcakton se *“Kush i shkakton tjetrit lëndim trupor ose ia dëmton shëndetin ka për detyrë të shpërblejë shpenzimet rreth mjekimit dhe shpenzimet tjera të nevojshme lidhur me këtë,...”*. Të nenit 200 të po këtij ligji i cili përcakton se *“Për dhimbjet e pësuar fizike, për dhimbjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor..., do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla...”*. ndërsa par. 2 përcakton *“ Me rastin e vendosjes për kërkesën mbi kompensimin e dëmit jomaterial, si dhe mbi shumën e kompensimit të tij, gjykata merr parasysh rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky kompensim, e gjithashtu edhe për faktin se më të mos u shkoj përshtat synimeve që nuk janë të përshtatshme me natyrën e saj...”*. Ndërsa neni 14 i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) përcakton se *“Në procedurën kontestimore gjykata në pikpamje të ekzistimit të veprës penale dhe të përgjegjësisë penale të kryerësit, është e lidhur me aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës penale, me të cilin i pandehuri është shpallur fajtor”*. Ndërsa neni 323 i LPK-së, përcakton se *“Poqëse vërtetohet se palës i takon e drejta që t’i shpërblehet dëmi në të holla apo me sende të zëvendësueshme, por pa mundësi që të caktohet shuma e të hollave, apo sasia e sendeve të tilla, apo se një gjë e tillë do të mund të bëhej me vështirësi shumë të mëdha, gjykata për këtë do të vendos sipas çmuarjes së lirë të saj”*.

Më tej ka arsyetuar se: Me rastin e vendosjes si në dispozitiv nën I të këtij aktgjykimi, gjykata vlerësoi se shumatat e kompensimit janë adekuate, duke marr parasysh dëmin që i është shkaktuar paditësit dhe se lartësia e shumës së të hollave në emër të kompensimit, do t’i mundësoj të dëmtuarit-këtu paditësit, satisfaksion që ai të jetë në gjendje që deri në një masë, t’i kompensojë të mirat jomateriale nga të cilat është privuar, respektivisht atë shkallë të satisfaksionit të cilën ai do ta kishte po qesë të njëjtat nuk do t’i kishte humbur, e krejt kjo duke pasur parasysh të gjitha rrethanat e lëndimeve të shkaktuara, intensitetin e dhimbjeve dhe të frikës, kohëzgjatjen e tyre, kohën e nevojshme të shërimit dhe nevojat e shtuara të ushqimisë, zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shkallën prej 1,5 %, shëmtimin të gjitha këto të përshkruara më hollësisht në ekspertizën e ekspertëve përkatës, të cilave gjykata ia fali besimin e plotë ngase janë përgatitur në mënyrë profesionale.

Lidhur me mënyrën e vendosjes, gjykata e shkallës së parë është mbështetur në dispozitat e nenit 323 dhe 14 të LPK-së e lidhur me në nenin 154 par.1 të LMD-së, dhe nenet 195 dhe 200 të LMD-së.

Vendimi mbi kamatën e gjykuar është marrë në kuptim të nenit 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, sa i përket dëmit jo material, ndërsa për dëmin material sipas Mendimit Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë në kuptim të nenit 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit, nisur nga kjo gjendje e çështjes pajtohet me pikëpamjet juridike të gjykatës së shkallës së parë pasi që përfundimi i saj është i rregullt dhe i ligjshëm për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, e gjithashtu nuk përmban shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit aktgjykimi i shkallës së parë, nuk është i përfshirë me të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet dhe në lidhshmëri me këtë dispozitiv i aktgjykimit është i qartë dhe i përmbanueshëm dhe përmban arsye për të gjitha faktet vendimtare të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë e sipas të cilave edhe është vendosë lidhur me themelësinë e kërkesëpadisë. Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsye të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre.

Gjykata e Apelit vlerëson se nga shkresat e lëndës konstatohet se të gjitha faktet e çështjes janë provuar me prova përkatëse të cilat janë administruar në një proces të rregullt gjyqësor. Përgjegjësia e të paditurve për kompensimin e dëmit në lartësinë e përgjegjësisë së tyre është vërtetuar nga aktgjykimi Penal P.nr. P.nr.284/2009 të datës 23.06.2014, përmes të cilit, të paditurit Ilirijan Bytyqi dhe Kushtrim Elezkurtaç që të dytë nga Prizreni janë shpall fajtor për shkak të veprës penale të lëndimit të rëndë trupor nga neni 154 par.1 nën par.2 lidhur me nenin 23 të KPK-së dhe janë dënuar me dënim me burg në kohëzgjatje prej 2 viteve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat prej 4 viteve, lidhur me lëndimet të rënda që ka pësuar këtu paditësi A.R.më datën 04.02.2009 e gjithashtu me prova tjera që gjinden në shkresat e lëndës. Gjithashtu gjykata e shkallës së parë, lartësinë e kërkesës së paditësit e ka vërtetuar nga ekspertizat mjekësore që gjinden në shkresat e lëndës. Gjendjen faktike për dëmin jo material dhe material për paditësin, gjykata e shkallës së parë e ka provuar përmes mendimit të ekspertit mjeko-ligjor, Dr. Naim Fanaj, Psikiatër dhe Dr.Xhemajl Selmani Ortoped - traumatolog, për të gjitha kategoritë e dëmit jo-material duke u bazuar edhe në vlerësim të lirë nga ana e gjykatës së shkallës së parë, mendimin e ekspertëve mjeko-ligjor e ka vlerësuar si profesionale, gjithëpërfshirëse dhe reale, duke pas parasysh natyrën e lëndimeve, frikës së përjetuar, lartësinë e zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësorë si dhe shkallën e shëmtimit dhe se kompensimi i dëmit jo-material në të holla ka për qëllim satisfaksionin për të dëmtuarin dhe jo që të arrihet ndonjë qëllim tjetër shoqëror i këtij kompensimi.

Gjykata e shkallës së parë, ka dhënë shpjegimet e duhura në arsyetim të aktgjykimit, për shumën e gjykuar për natyrën e lëndimeve, frikës së përjetuar, lartësinë e zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësorë si dhe shkallën e shëmtimit. Andaj, si përfundim e ka marrë për bazë mendimin e ekspertëve mjekësore, prandaj, Gjykata e Apelit vlerëson se shumata e aprovuara për dëmin jo materiale dhe material, janë në përputhje edhe me lëndimet e shkaktuara paditësit dhe të njëjtat paraqesin satisfaksion në raport me lëndimet e marra, intensitetin e dhimbjeve dhe të frikës, kohëzgjatjen e tyre si dhe kohën e nevojshme për shërimin, zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësorë në shkallë prej 1.5%, lartësinë e shëmtimit truporë e të cilat janë konstatuar edhe nga ekspertizat e ekspertëve mjeko-ligjor, Dr. Naim Fanaj, Psikiatër dhe Dr.Xhemajl Selmani Ortoped - traumatolog. Në çdo rast për dëmin jo material, gjykata duhet të ketë në konsideratë rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe qëllimit të cilit i shërben ky kompensim, duke u

kujdesur që kompensimi tu shkoj përshtati qëllimeve që synohen me kompensimin e dëmit jo material e që është satisfaksion për të dëmtuarin.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë, nga gjendja faktike e vërtetuar, në mënyrë të drejtë ka aplikuar edhe të drejtën materiale pasi që sipas nenit 154 i LMD-së së vitit 1978, i cili ka qenë në fuqi në kohën e shkaktimit të dëmit, i cili përcakton se *“Kush i shkakton tjetrit dëmin, ka për detyrë ta kompensoj, në qoftëse nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij”*, të nenit 195 par.1 i po të njëjtit ligj, i cili përcakton se *“Kush i shkakton tjetrit lëndim trupor ose ia dëmton shëndetin ka për detyrë të shpërblejë shpenzimet rreth mjekimit dhe shpenzimet tjera të nevojshme lidhur me këtë,...”*. Të nenit 200 i po të njëjtit ligj, i cili përcakton se *“Për dhimbjet e pësuar fizike, për dhimbjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor..., do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla...”*. ndërsa par. 2 përcakton *“ Me rastin e vendosjes për kërkesën mbi kompensimin e dëmit jomaterial, si dhe mbi shumën e kompensimit të tij, gjykata merr parasysh rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky kompensim, e gjithashtu edhe për faktin se më të mos u shkoj përshtat synimeve që nuk janë të përshtatshme me natyrën e saj..”*. Ndërsa neni 14 i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) përcakton se *“Në procedurën kontestimore gjykata në pikpamje të ekzistimit të veprës penale dhe të përgjegjësisë penale të kryerësit, është e lidhur me aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës penale, me të cilin i pandehuri është shpallur fajtor”*. Andaj, gjykata e shkallës së parë është bazuar në dispozitat materialo-juridike të cilave u është referuar, e në përputhje me gjendjen faktike, duke marrë në konsideratë intensitetin e dhimbjeve dhe të frikës, kohëzgjatjen e tyre si dhe kohën e nevojshme për shërimin, zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shkallë prej 1.5%, lartësinë e shëmtimit truporë dhe rrethanat tjera që ndikojnë në përcaktimin e lartësisë së kompensimit siç janë natyra intensiteti dhe kohëzgjatja e frikës, rrethanat tjera, e sidomos moshën e paditësit si dhe praktika gjyqësore të cilat rezultojnë se shumata e gjykuara janë në përputhje të plotë me qëllimin shoqëror për kompensimin e dëmit. Gjykata ka vendosur në mënyrë të ekuilibruar në mes të shumës së gjykuar dhe dëmeve që ka pësuar paditësit, duke siguruar që kompensimi i gjykuar të jetë satisfaksion për paditësit, duke shmangur qëllimet tjera materiale që mund të bien ndesh me qëllimin e satisfaksionit.

Përveç kësaj Gjykata e Apelit e mbështet vendimin e gjykatës së shkallës së parë përkitazi me kërkesëpadinë e paditësit sa i përket dëmit material për ushqim të përforcuar dhe ndihmën e personit të tretë, pasi që ky lloj kompensimi i gjykuar sipas aktgjykimit të ankimuar është në harmoni me rrethanat e tjera të krijuara si dhe me vlerësimin e ekspertëve mjekësor, të cilët kanë konstatuar se për paditësin ka qenë e nevojshme ushqimi i përforcuar për 30 muaj, ndihma e personit të tretë në kohëzgjatje prej 21 ditë, dëme ky që është i mbështetur edhe në provat materiale që gjinden në shkresat e lëndës si dhe nevojat e paditësit të përcaktuara nga ekspertët e cekur si më lartë.

Gjykata e Apelit i vlerësoj pretendimet e të paditurit në lidhje me atë se i njëjti nuk ka qenë i ftuar asnjë herë për në seancë nga ana e gjykatës së shkallës së parë, por të njëjtat pretendime nuk i mori për bazë pasi që duke shikuar në shkresat e lëndës vërtetohet se i padituri nga ana e gjykatës së shkallës së parë vazhdimisht është ftuar në mënyrë të rregullt, por i njëjti mungesën për seancë nuk e ka arsyetuar, gjë që ka qenë obligim i të paditurit që të njoftoj gjykatën për mos prezencë në seancë duke i treguar dhe arsyet e mos prezencës. Andaj, në këtë kuptim nuk mund të thuhet se i padituri nuk është ftuar në seancë dhe i është mohuar e drejta për të marrë pjesë në gjykim, pasi që i njëjti me veprimet e veta ka hequr dorë nga kjo e drejtë.

Sa i përket vendimit për kamatën e gjykuar nga gjykata e shkallë së parë, edhe gjykata e Apelit e përkrah një vendim të tillë pasi që kamata e gjykuar është në pajtueshmëri të plotë me nenin 382 të LMD-së.

Sa i përket vendimit për shpenzimet procedurale të gjykuara nga gjykata e shkallë së parë, edhe gjykata e Apelit e përkrah një vendim të tillë pasi që shpenzimet e aprovuara janë shpenzime në përputhshmëri të plotë me veprimet procedurale, pasi që janë veprime të domosdoshme, e gjithashtu duke pas parasysh edhe suksesin e paditësit në procedurë dhe atë në kuptim të nenit 452.1 të LPK-së lidhur me tarifën e OAK.

Janë vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore, por Gjykata e Apelit, nuk ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Gjykata e Apelit vendosi si në pikën II të këtij aktgjykimi, duke mos e shqyrtuar fare pikën III të aktgjykimit të ankimuar, në kuptim të nenit 194 të LPK-së, pasi që për këtë pikë nuk kishte pretendime ankimore.

Nga arsyet e cekura më lartë, Gjykata e Apelit në bazë të nenit nenin 194 dhe 195 par. 1 pika d), të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - PRISHTINË  
AC.nr. 7780/2022, me datë 26.03.2024

Kryetar i kolegjit, Gjyqtari  
Besnik Bislimaj, d.v